FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 68 20 qershor 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 343, datë 23.5.2012	Për caktimin e anëtarëve, përfaqësues të Këshillit të Ministrave, në Këshillin Mbikëqyrës të Agjencisë së Trajtimit të Kredive	3251
Vendim i KM nr. 345, datë 9.5.2012	Për një shtesë në vendimin nr. 502, datë 13.7.2011 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit"	3251
Vendim i KM nr. 347, datë 23.5.2012	Për një shtesë në vendimin nr.208, datë 24.3.2010 të Këshillit të Ministrave "Për dhënie ndihme financiare Qeverisë së Kosovës për realizimin e projekteve të propozuara për komunën Graçanicë, Kosovë", të ndryshuar	3252
Vendim i KM nr. 349, datë 23.5.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Kryeministrinë	3252
Vendim i KM nr. 352, datë 23.5.2012	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi të shoqërisë "Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2", sh.a.....	3253
Vendim i KM nr. 353, datë 23.5.2012	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërisë "Hec Ulëz - Shkopet", sh.a.....	3253
Vendim i KM nr. 357, datë 23.5.2012	Për një shtesë në vendimin nr.1242, datë 16.12.2009 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e funksionimit të komisionit të ankandit, procedurat e zhvillimit të ankandit, kriteret e vlerësimit të pronës, që nxirret në ankand, si dhe për mënyrën e indeksimit të përfitimit financiar mujor".....	3254

Vendim i KM nr. 361, datë 30.5.2012	Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të administrimit të shoqërive huamarrëse ……	3255
Vendim i KM nr. 362, datë 16.5.2012	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.1158, datë 13.8.2008 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave për rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuara në serrat me ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale e agroindustriale, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit"……	3256
Vendim i KM nr.364, datë 30.5.2012	Për rishpërndarjen në numrin e punonjësve dhe të fondeve buxhetore, miratuar për vitin 2012, nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Agjencisë së Prokurimit Publik ……	3258
Vendim i KM nr. 367, datë 30.5.2012	Për një shtesë në vendimin nr.508, datë 19.7.2006 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në territorin administrativ të Komunës Bicaj, të qarkut Kukës", dhe miratimin e listës së pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të komunës Bicaj, të qarkut të Kuksit ……	3259
Vendim i KM nr. 369, datë 30.5.2012	Për një shtesë në vendimin nr.763, datë 28.5.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në territorin administrativ të komunës Karinë, të qarkut të Elbasanit", dhe miratimin e listës së pronave, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të komunës Karinë, të qarkut të Elbasanit ……	3260
Vendim i KM nr.370, datë 30.5.2012	Për një ndryshim në vendimin nr.90, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike në territorin administrativ të komunës Shezë, të qarkut Elbasan", dhe për një ndryshim në vendimin nr.131, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së pyjeve dhe kullotave që transferohen në përdorim të komunës Shezë, të qarkut Elbasan" ……	3261
Vendim i KM nr. 371, datë 30.5.2012	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë, për bashkëpunimin në fushën e veterinarisë ……	3262
Udhëzim i MASH nr. 7, datë 22.5.2012	Për masat për zhvillimin e provimeve të lirimit dhe të provimeve të Maturës Shtetërore 2012 ……	3265
Udhëzim i MD nr. 282, datë 15.6.2012	Për mbajtjen e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio ……	3267
Urdhër i MB nr. 90, datë 30.5.2012	Për dokumentet që duhet të paraqesin shtetasit shqiptarë për ndryshimin e emrit/mbiemrit në zyrat e gjendjes civile dhe procedurën që duhet të ndjekë nëpunësi i gjendjes civile ……	3275

Vendim i KKRT nr. 69, datë 24.5.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor "TV kabllor Delvina"	3277
Vendim i KKRT nr. 70, datë 24.5.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor "TV Super Sonic"	3278
Vendim i KKRT nr. 71, datë 24.5.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor "TV Margit"	3278
Vendim i KKRT nr. 72, datë 24.5.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor "TV Saranda"	3279
Vendim i KKRT nr. 83, datë 24.5.2012	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor "TV Rozafa Motiv"	3279
Kërkesë e MPPT nr. 906/3, datë 21.5.2012	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Vora By Pass", Tiranë.....	3280
Kërkesë e MPPT nr. 2437, datë 23.5.2012	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Qafë-Thanë-Lin-Pogradec", loti I (shtesat)	3281
Kërkesë e METE nr. 4753/3, datë 31.5.2012	Për shpronësim, me interes publik, të pasurive të paluajtshme të tipit tokë bujqësore, tokë truall, ndërtim, shtëpi banimi dhe "kulturave bujqësore", që preken nga "Ndërtimi i linjës 110 kV Tirana 2-nënstacioni 110 kV Kashar-Selitë"	3282

VENDIM
Nr. 343, datë 23.5.2012

PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE, PËRFAQËSUES TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, NË KËSHILLIN MBIKËQYRËS TË AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË KREDIVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 1 të ligjit nr. 8894, datë 14.5.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e anëtarëve, përfaqësues të Këshillit të Ministrave, në këshillin mbikëqyrës të Agjencisë së Trajtimit të Kredive, si më poshtë vijon:

- Znj. Roza Nauni ekonomiste;
- Z. Hasan Metuku jurist;
- Z. Xhentil Demiraj ekonomist.

2. Anëtarët e caktuar në pikën 1 të këtij vendimi , e ushtrojnë funksionin deri në përfundim të afatit të veprimtarisë së Agjencisë së Trajtimit të Kredive, sipas nenit 23 të ligjit nr. 8894, datë 14.5.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive", të ndryshuar. Në çdo rast, ata nuk mund ta ushtrojnë këtë funksion për një mandat mbi tre vjet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 345, datë 9.5.2012

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 502, DATË 13.7.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES UNIFORME TË KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 62 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 1/3 të nenit 47 të rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 502, datë 13.7.2011 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 1/4, me këtë përmbajtje:

"1/4. Studimet urbanistike, lejet e sheshit të ndërtimit, si dhe lejet e ndërtimit, të shqyrtuara në sekretarinë teknike të KRRTRSH-së para hyrjes në fuqi me efekte të plota të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, të shqyrtohen dhe të miratohen përfundimisht në KKT. Strukturat e ngarkuara për zbatimin e këtyre vendimeve do të bëjnë përshtatjen e terminologjisë së tyre, sipas përcaktimeve të pikës 1/3 të këtij neni.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 347, datë 23.5.2012

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 208, DATË 24.3.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE QEVERISË SË KOSOVËS PËR REALIZIMIN E PROJEKTEVE TË PROPOZUARA PËR KOMUNËN GRAÇANICË, KOSOVË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2 të vendimit nr. 208, datë 24.3.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/3, me këtë përmbajtje:

"2/3. Kundërvlera në lekë e fondeve të pashpenzuara brenda vitit 2011, në vlerën 55 000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro, t'i shtohet buxhetit të miratuar për vitin 2012 për Fondin Shqiptar të Zhvillimit, për t'u përdorur në formën e transfertës.".

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit dhe të konvertohet në monedhën vendase (në ALL), në çastin e kalimit të tij.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 349, datë 23.5.2012

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR KRYEMINISTRINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryeministrisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, zëri "Shpenzime korente (602)", t'i shtohet fondi prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh, për financimin e Konferencës V të nivelit të lartë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, që do të zhvillohet në Tiranë, në datat 27 - 29 qershor 2012.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Kryeministria për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 352, datë 23.5.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË SHOQËRISË "HEC BISTRICA 1 DHE BISTRICA 2" SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të prodhimit të energjisë elektrike, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi të shoqërisë "HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2" sh.a., sipas lidhjeve (gjithsej 2 (dy) fletë), që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Heqjen e pasurive të mësipërme nga inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, të sistemit të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, në përgjegjësi administrimi të KESH sh.a. miratuar me vendimin nr. 122, datë 4.3.2004 të Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 353, datë 23.5.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHOQËRISË "HEC ULËZ - SHKOPET" SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të prodhimit të energjisë elektrike, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërisë "HEC Ulëz - Shkopet" sh.a., sipas lidhjeve (gjithsej 3 (tre) fletë) që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Heqjen e pasurive të sipërpërmendura nga inventari i pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, në përgjegjësi administrimi të KESH sh.a. miratuar me vendimin nr. 122, datë 4.3.2004 të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 357, datë 23.5.2012

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 1242, DATË 16.12.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR RREGULLAT E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË ANKANDIT, PROCEDURAT E ZHVILLIMIT TË ANKANDIT, KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS, QË NXIRRET NË ANKAND, SI DHE PËR MËNYRËN E INDEKSIMIT TË PËRFITIMIT FINANCIAR MUJOR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 8 të ligjit nr. 10 160, datë 15.10.2009 "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 2, të kreut XIII, të vendimit nr. 1242, datë 16.12.2009 të Këshillit të Ministrave, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Për mjetet e grumbulluara në rezervat e shtetit, të cilat nuk janë shitur pasi u janë nënshtruar procedurave të shitjes me ankand publik për tri herë me radhë, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit vijon me procedurat e transferimit pa pagesë të tyre e më pas vijon me procedurat e tjetërsimit, sipas kritereve dhe rregullave për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, të përcaktuara në aktet, ligjore e nënligjore, përkatëse, dhe njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për heqjen nga qarkullimi dhe çregjistrimin e këtyre mjeteve.".

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 361, datë 30.5.2012

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3 të ligjit nr. 41/2012 "Për afatet dhe procedurat e mbylljes së procesit të kontrollit financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë" dhe të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit e administrimit të shoqërive huamarrëse është si më poshtë vijon:

a) Paga e administratorit të shoqërive huamarrëse barazohet me pagën e funksionit "drejtor drejtorie në ministri" dhe klasifikohet në nivelin II-b.

b) Paga e specialistit barazohet me pagën e funksionit "specialist i nivelit të dytë" dhe klasifikohet në nivelin IV-a.

Vlera përkatëse e pagës për çdo kategori dhe përllogaritja e pagës bruto mujore bëhet në përputhje me pikën 2 të vendimit nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit.".

2. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit mbështetës të administrimit të shoqërive huamarrëse janë të njëjta me ato të punonjësve mbështetës në institucionet buxhetore dhe llogariten në përputhje me vendimin nr. 717, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore".

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për administratorin hyjnë në fuqi nga data e emërimit të tij, ndërsa për punonjësit e tjerë pas miratimit të strukturës dhe përballohen nga të ardhurat e shoqërive.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 362, datë 16.5.2012

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 1158, DATË 13.8.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË PROCEDURAVE PËR RIMBURSIMIN E AKCIZËS SË LËNDËVE DJEGËSE, TË KONSUMUARA NË SERRAT ME NGROHJE, PËR PRODHIMIN E PRODUKTEVE INDUSTRIALE E AGROINDUSTRIALE, TË CILAT PËRDOREN PËR NEVOJA TEKNOLOGJIKE TË PRODHIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "d" të pikës 2 të nenit 19 të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1158, datë 13.8.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet dhe shtesa, si më poshtë vijon:

a) Në fjalinë e parë, fjalët "… solar dhe mazut …" zëvendësohen me "… të specifikuara në sesionin IV "Nënproduktet e naftës" të shtojcës nr. 1 të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar, të cilat plotësojnë kërkesat dhe standardet, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të nënproduktit "Naftë virgine", të përshkruar me kodin 27 10 11 11…".

b) Pas fjalëve "… të konsumuara …" shtohen "… në industrinë e riciklimit të plastikës, qelqit dhe të përzier …".

c) shkronjat "a" dhe "b" shfuqizohen dhe zëvendësohen me shkronjën "a" me këtë përmbajtje:

"a) Skema e rimbursimit është proporcionale, si më poshtë vijon:

- gjatë tri viteve të para, 2011-2014, do të kryhet rimbursim 100% i akcizës;
- në vitin e katërt, viti 2015, do të bëhet rimbursim në masën 80% të akcizës;
- në vitin e pestë, viti 2016, do të bëhet rimbursim në masën 50%.

Subjektet, të cilat kanë përfituar rimbursim 100% të akcizës, në bazë të vendimit nr. 1158, datë 13.8.2008 të Këshillit të Ministrave, do të vazhdojnë të marrin rimbursimin 100% deri në vitin 2014 dhe, më pas, sipas skemës proporcionale të përcaktuar në shkronjën "a" të këtij vendimi.".

2. Në pikat 2, paragrafi i parë, dhe 3, fjalët "… solar dhe mazut …" hiqen, ndërsa pas fjalëve "… të konsumuara …", shtohen "… në industrinë e riciklimit të plastikës, qelqit dhe të përzier …".

3. Shtojca nr. 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1158, datë 13.8.2008 të Këshillit të Ministrave, që shërben si tabelë referuese për normativat e harxhimit të lëndës djegëse, për industritë, objekte të këtij vendimi, zëvendësohet me shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Rimbursimi i akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuara në serrat me ngrohje, industrinë e riciklimit të plastikës, qelqit dhe të përzier, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë, në përputhje me sasinë e produktit final, të shitur me faturë TVSH-je, bëhet nga drejtoria rajonale e tatimeve, ku është i regjistruar subjekti, në mënyrë automatike, pas paraqitjes së kërkesës.

5.1 Brenda datës 10 të muajit pasardhës, subjekti paraqet kërkesën për rimbursim. Me paraqitjen e kërkesës për rimbursim nga subjekti, drejtoria rajonale tatimore, ku subjekti është i regjistruar, është e detyruar të kryejë rimbursimin automatik të shumës së kërkuar, në rast se kërkesa për rimbursim plotëson kushtet e mëposhtme:

a) subjekti nuk bën kërkesë për rimbursim për herë të parë;

b) është audituar në 3 (tri) vitet e fundit;

c) nuk ka asnjë detyrim tatimor ose kontribute a penalitete pa u paguar;

ç) ka deklarim të rregullt të TVSH-së.

5.2 Kërkesa për plotësimin e kritereve të mësipërme për rimbursimin automatik vlerësohet nga inspektorët e drejtorisë rajonale tatimore, të cilët procedojnë brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës. Kërkuesit për rimbursim mund të kontaktohen për të sqaruar problemet, por atyre nuk do t'u kërkohen dokumente shtesë, përveç atyre të përcaktuara në këtë pikë. Ato kërkesa që nuk plotësojnë kushtet, do të dërgohen për kontroll dhe kërkuesit mund t'i kërkohet të paraqesë dokumente shtesë.

5.3 Në rast se kërkesa për rimbursim paraqitet nga një person i tatueshëm për herë të parë, drejtoria rajonale tatimore duhet të verifikojë në vend saktësinë e shumës së rimbursimit të kërkuar dhe e miraton atë, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim. Kontrolli i kërkesave për rimbursim bëhet duke respektuar radhën e kërkesave. Rimbursimi kryhet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, pas miratimit të shumës për t'u rimbursuar.

5.4 Në rast se drejtoria rajonale tatimore, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, nuk procedon me rimbursimin automatik, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore, me përjashtim të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, në masën e akcizës së pretenduar për rimbursim.

5.5 Në rast se gjatë kontrollit rezulton se ka pasur pasaktësi ose pavërtetësi të dokumenteve, subjekti përfitues i rimbursimit duhet të kthejë të gjithë shumën e rimbursuar, si dhe mbi të aplikohen penalitetet e përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA 1
TABELA REFERUESE E DISA NORMATIVAVE TË HARXHIMIT TË LËNDËS DJEGËSE
AGRO-INDUSTRIA

Nr.	**Aktiviteti**	**Procesi teknologjik**	**Sasia e lëndës djegëse litër/1 ton prodhim**	
			Mazut	**Solar**
1	Përpunim qumështi	Sterilizim, pasterizim	26-32	24-29
2	Prodhim ëmbëlsirash	Pjekje	42-53	39-48
3	Prodhim birre	Sterizilim, pjekje	26-32	24-29
4	Prodhim pijesh	Sterizilim, pjekje	26-32	24-29
5	Përpunim frutash	Sterilizim	26-32	24-29
6	Prodhim vaji	Sterilizim	26-32	24-29

Nr.	Aktiviteti	Procesi teknologjik	Sasia e lëndës djegëse litër/1 ton prodhim		
			Gazoil (diezel)	Mazut	Solar
	Prodhim buke	Pjekje	45-50	42-53	39-48

Serrat me ngrohje

Nr.	Aktiviteti	Procesi teknologjik	Sasia e lëndës djegëse litër/1 dynym sipërfaqe	
			Mazut	Solar
	Prodhim perimesh	Ngrohje e ambientit	10 000	10 000

Industria*

Nr.	Aktiviteti	Proceset teknologjike	Sasia e lëndës djegëse për njësi të produktit final	
			Solar ose mazut	Koks
1	Prodhim tullash dhe tjegullash me pjekje termike etj.	Ngrohje, tharje dhe pjekje të tullave dhe të tjegullave	4 kg solar për një 1 kv produkt final	
2	Prodhim çimento		Sipas kartës teknologjike	Sipas kartës
3	Riciklim i plastikës, qelqit dhe të përzier		Sipas kartës teknologjike	

*Shënim. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, do të bëjë përditësimin e normativave të harxhimit të lëndëve djegëse për të gjithë sektorët e industrisë që përfitojnë nga skema e rimbursimit të akcizës.

VENDIM
Nr. 364, datë 30.5.2012

PËR RISHPËRNDARJEN NË NUMRIN E PUNONJËSVE DHE TË FONDEVE BUXHETORE, MIRATUAR PËR VITIN 2012, NGA MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të neneve 10 e 11 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në numrin e përgjithshëm të punonjësve në ministritë dhe institucionet buxhetore, miratuar për vitin 2012, të bëhet rishpërndarja, si më poshtë vijon:

a) Agjencisë së Prokurimit Publik t'i shtohen 2 (dy) punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm për këtë institucion, për vitin 2012, në 20 veta.

b) Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës t'i pakësohen 2 (dy) punonjës, nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, duke e çuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të kësaj ministrie, për vitin 2012 në 776 veta.

2. Në buxhetin e miratuar për vitin 2012 të bëhet rishpërndarje e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Agjencisë së Prokurimit Publik, në programin "Shërbimi i prokurimit publik", t'i shtohet fondi i shpenzimeve të personelit me 1 025 000 (një milion e njëzet e pesë mijë) lekë.

b) Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në programin "Mbështetje për zhvillim ekonomik", t'i pakësohet fondi 1 025 000 (një milion e njëzet e pesë mijë) lekë, nga shpenzimet e personelit.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 367, datë 30.5.2012

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 508, DATË 19.7.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË KOMUNËS BICAJ, TË QARKUT KUKËS", DHE MIRATIMIN E LISTËS SË PYJEVE DHE KULLOTAVE QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KOMUNËS BICAJ, TË QARKUT KUKËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar dhe të nenit 23 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës shtesë të pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, në territorin administrativ të komunës Bicaj, të qarkut Kukës. Lista ka 9 (nëntë) fletë dhe mbaron me numrin rendor 259 (dyqind e pesëdhjetë e nëntë).

2. Miratimin e listës së pronave të paluajtshme të tipit, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të komunës Bicaj, të qarkut Kukës. Lista ka 9 (nëntë) fletë e mbaron me numrin rendor 259 (dyqind e pesëdhjetë e nëntë).

3. Ndryshimet në listën e inventarit dhe në listën përfundimtare të pyjeve dhe kullotave, që transferohen në pronësi, si dhe lidhja nr. 1 (një), i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Bicaj, e qarkut Kukës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore: Bicaj, qarku Kukës

Lidhja nr. 1

Numrat e pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
251-509	Pyll, kullotë	Pronësi

VENDIM
Nr. 369, datë 30.5.2012

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 763, DATË 28.5.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË KOMUNËS KARINË, TË QARKUT TË ELBASANIT", DHE MIRATIMIN E LISTËS SË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KOMUNËS KARINË, TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e një shtese në listën e inventarit të pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, në territorin administrativ të komunës Karinë, të qarkut të Elbasanit. Lista është me 1 (një) fletë dhe përfundon me numër rendor 10 (dhjetë).

2. Miratimin e listës së pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që transferohen në pronësi të kësaj njësie. Lista ka 2 (dy) fletë dhe përfundon me numër rendor 26 (njëzet e gjashtë).

3. Lista shtesë e inventarit, lista e pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të komunës Karinë, të qarkut të Elbasanit dhe lidhja nr. 1 (një), i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Karinë, e qarkut të Elbasanit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore: Karinë
Qarku Elbasan

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
362-376; 387	Pyje	Pronësi
377-385	Kullotë	Pronësi
386	Sipërfaqe me bimësi pyjore	Pronësi

VENDIM
Nr. 370, datë 30.5.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 90, DATË 31.1.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË KOMUNËS SHEZË, TË QARKUT ELBASAN", DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 131, DATË 3.2.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PYJEVE DHE KULLOTAVE QË TRANSFEROHEN NË PËRDORIM TË KOMUNËS SHEZË, TË QARKUT ELBASAN"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" dhe të nenit 8 pika 3 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës shtesë të inventarit të pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, në territorin administrativ të komunës Shezë. Lista është me 1 (një) fletë dhe përfundon me numrin rendor 5 (pesë).

2. Miratimin e ndryshimit të formës së transferimit, nga "përdorim" në "pronësi" dhe shtesës në listën e pyjeve dhe kullotave të transferuara në përdorim të komunës Shezë, të qarkut Elbasan, sipas formularit me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 15 (pesëmbëdhjetë).

3. Lista shtesë e inventarit, lista e transferimit dhe lidhja nr. 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Shezë, e qarkut të Elbasanit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore: Shezë
Qarku Elbasan

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
190-199	Pyll	Pronësi
409-413	Kullotë	Pronësi

VENDIM
Nr. 371, datë 30.5.2012

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË, PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E VETERINARISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Serbisë, për bashkëpunimin në fushën e veterinarisë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E VETERINARISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Serbisë (më poshtë të referuara si "Palët kontraktuese"), me dëshirën për të lehtësuar lëvizjen e kafshëve, produkteve dhe ushqimeve me origjinë shtazore, dhe në të njëjtën kohë për të parandaluar futjen e sëmundjeve të transmetueshme shtazore, të produkteve dhe ushqimeve me origjinë shtazore të pasigurta, si dhe për të zhvilluar bashkëpunimin në fushën veterinare dhe sigurisë ushqimore, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Importi dhe transiti i kafshëve, produkteve dhe ushqimeve me origjinë shtazore (më poshtë të referuara si dërgesë) mund të kryhen vetëm në rast se plotësohen kushtet e detyrueshme veterinare sanitare dhe nëse është marrë miratimi paraprak i autoritetit kompetent të vendit importues dhe të vendit nëpër territorin e të cilit dërgesa do të transitohet.

Autoritetet kompetente të palëve kontraktuese do të këmbejnë modelet e certifikatave veterinare-sanitare (më poshtë të referuara si "certifikata"), të cilat do të shoqërojnë dërgesat në Republikën e Serbisë dhe në Republikën e Shqipërisë dhe do të mbajnë njëri-tjetrin të informuar për ndryshimet dhe shtesat e tyre.

Certifikatat veterinare-sanitare duhet të jenë të shtypura në gjuhët serbisht, shqip dhe anglisht.

Neni 2

Autoritetet kompetente të secilës palë kontraktuese:

1. do të informojnë njëri-tjetrin për kushtet veterinare-sanitare për importin dhe transitin e dërgesave;

2. do të shkëmbejnë raporte mujore mbi gjendjen e sëmundjeve të transmetueshme shtazore që duhet të regjistrohen në territorin e tyre, duke deklaruar emrat e vendeve, kodet dhe emrat e rajoneve epizootologjike dhe epidemiologjike;

3. do të informojnë njëri-tjetrin me shkrim, brenda 24 orëve, mbi një shpërthim të sëmundjeve shtazore, që duhet të regjistrohen menjëherë, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve (OIE), si dhe gjithashtu ecurinë e sëmundjes dhe në rastin e sëmundjes së aftës epizootike, duhet të citojnë virusin, karakterin e sëmundjes, masat e marra dhe burimin e shkaktarit.

Neni 3

Me qëllim zhvillimin e bashkëpunimit në fushën veterinare dhe sigurisë ushqimore, autoritetet kompetente të palëve kontraktuese:

1. do të shkëmbejnë rregullore në fushën veterinare dhe botime të tjera profesionale;

2. do të shkëmbejnë planin model të mbetjeve për vitin në vazhdim dhe rezultatet model të planit të mbetjeve të vitit të mëparshëm;

3. do të nxisin bashkëpunimin midis institucioneve shkencore që merren me studime dhe kërkime për sëmundjet shtazore dhe sistemet e kontrollit veterinar-sanitar të ushqimeve me origjinë shtazore, si dhe bashkëpunimin ndërmjet laboratorëve diagnostikë dhe analitikë;

4. do të japin ndihmë të ndërsjellë në prodhimin dhe blerjen e mjeteve për parandalimin e sëmundjes dhe trajtimin shëndetësor të kafshëve;

5. do të shkëmbejnë në rast nevoje, shtamet e sëmundjeve patogjene dhe parazitare shtazore për qëllime eksperimentale dhe diagnostike, si dhe të mjeteve diagnostike;

6. do të nxisin bashkëpunimin midis autoriteteve veterinare dhe shkëmbejnë ekspertë veterinarë me qëllim që të informohen me organizimin dhe veprimtaritë e shërbimit veterinar të palës tjetër kontraktuese, gjendjen e kushteve të eksportit, të shëndetit të kafshëve dhe të sistemit të informacionit të shëndetit të kafshëve;

7. do të bëjnë përpjekje për të organizuar takime vjetore ekspertësh mbi baza reciproke;

8. do të shkëmbejnë informacion periodik mbi qendrat e miratuara që kryejnë veprimtari në përputhje me legjislacionin veterinar kombëtar.

Neni 4

Në qoftë se në pikën e hyrjes apo në vendin e destinacionit është përcaktuar që dërgesa nuk përputhet në kushtet veterinare-sanitare të deklaruara në certifikatë, autoriteti kompetent i palës kontraktuese në territorin e të cilit zbulohet mospërputhja do të informojë menjëherë autoritetin kompetent të palës tjetër kontraktuese dhe do të marrë masat në përputhje me rregullat e tij të brendshme.

Neni 5

Në qoftë se një sëmundje e transmetueshme shtazore është diagnostikuar në territorin e njërës nga palët kontraktuese, autoriteti kompetent i palës tjetër kontraktuese ka të drejtën të kufizojë ose të ndalojë importin dhe transitin e dërgesave të kafshëve të specieve të prekshme ndaj asaj

sëmundjeje, që vijnë nga territori i palës kontraktuese, në përputhje me kodin shëndetësor të kafshëve të tokës të OIE-së.

Kufizimi dhe ndalimi i importit dhe transitit mund të zbatohet me të njëjtat kushte për dërgesa të tjera me anë të së cilave mund të përhapet sëmundja.

Neni 6

Mosmarrëveshjet që lindin nga zbatimi i dispozitave të kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në nivelin e përfaqësuesve të autoriteteve kompetente të palëve kontraktuese. Në qoftë se nuk arrihet rezultati i dëshiruar në këtë mënyrë, mosmarrëveshja do të zgjidhet nëpërmjet rrugës diplomatike.

Neni 7

Autoriteti kompetent për zbatimin e kësaj marrëveshjeje në Republikën e Shqipërisë është Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria e Shërbimit Veterinar, me qendër në Tiranë.

Autoriteti kompetent për zbatimin e kësaj marrëveshjeje në Republikën e Serbisë është Ministria e Bujqësisë, Tregtisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujit, Drejtoria e Veterinarisë me qendër në Beograd.

Neni 8

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të të dyja palëve kontraktuese. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me nenin 10 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 9

Kjo marrëveshje nuk do të cenojë të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare në të cilat ato janë palë.

Neni 10

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditë nga data e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me të cilën palët kontraktuese kanë njoftuar njëra-tjetrën, nëpërmjet rrugëve diplomatike, se janë përmbushur kërkesat e tyre të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Kjo marrëveshje zbatohet për një periudhë 5-vjeçare (pesëvjeçare) dhe mund të ripërtërihet në mënyrë të heshtur për një periudhë shtesë 1-vjeçare (njëvjeçare), përveç kur njëra nga palët kontraktuese e denoncon atë me shkrim nëpërmjet rrugëve diplomatike të paktën gjashtë (6) muaj para.

Bërë në Beograd, më 27 prill 2012, në dy kopje origjinale në gjuhët shqip, serbisht dhe anglisht, ku secili nga tekstet është njëlloj i barasvlershëm. Në rast mospërputhjesh në interpretim mbizotëron teksti në anglisht.

UDHËZIM
Nr. 7, datë 22.5.2012

PËR MASAT PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË LIRIMIT DHE TË PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE, 2012

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 7592, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar, të vendimit nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe provimet në shkollat e larta publike", të ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 1013, datë 10.12.2010 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)",

UDHËZOJ:

KREU I
HARTIMI DHE VLERËSIMI I TESTEVE TË PROVIMEVE TË LIRIMIT

1. Hartimi dhe vlerësimi i testeve të provimeve të lirimit të bëhet sipas rregullores nr. 1298, datë 24.2.2012 "Për zhvillimin e provimeve të lirimit".

KREU II
PROVIMET E DETYRUARA DHE ME ZGJEDHJE TË MATURËS SHTETËRORE

1. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje do të zhvillohen në përputhje me modalitetet e përcaktuara në udhëzimin nr. 3, datë 28.2.2012 "Për zhvillimin e provimeve përfundimtare dhe provimeve të Maturës Shtetërore 2012".

2. Përzgjedhja e testit për secilin nga provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2012, kryhet nga specialistë të caktuar prej Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, të cilët emërohen përzgjedhës të testit përfundimtar (PTP) në kushtet e ruajtjes së plotë të sekretit, brenda ambienteve të izoluara të AKP-së.

3. Periudhat kohore të ekspozimit potencial të sekretit (KOEPS-eve) për Maturën Shtetërore 2012 të jenë:

a) 26 maj-2 qershor 2012, për lëndën "Gjuhë shqipe dhe letërsi";

b) 9 qershor-16 qershor 2012, për lëndën "Matematikë";

c) 23 qershor-30 qershor 2012, për lëndët me zgjedhje.

4. Lista e punonjësve të AKP-së, të cilët përfshihen në KOEPS, për secilën periudhë të përmendur në pikën 3, kreu II të këtij udhëzimi, miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i AKP-së. Specialistët e lëndëve përkatëse në AKP futen në KOEPS një ditë më pas nga datat e përcaktuara në pikën 3. Ata hartojnë së bashku me PTP-në skemat e vlerësimit të testeve dhe ndihmojnë më tej proceset e tjera të formatimit, shumëfishimit dhe shpërndarjes së testeve.

5. Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA), Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional (AKAFP) dhe Kulturë-Kontakt të marrin masat e mëposhtme, për lirimin e mjediseve dhe vënien e tyre në dispozicion të AKP-së, gjatë periudhës 25 maj-1 korrik 2012:

a) të zhvillojnë veprimtaritë e tyre në mjedise të tjera jashtë ndërtesës ku ndodhet AKP-ja;

b) të planifikojnë lejet e zakonshme për specialistët të cilët nuk janë angazhuar si përfaqësues të MASH-it, për ndjekjen e provimeve të Maturës Shtetërore 2012.

6. Pas zhvillimit të çdo provimi të Maturës Shtetërore 2012, testet e maturantëve/kandidatëve të dërgohen nën masa të rrepta sigurie në godinën e shkollës "Sabaudin Gabrani", Tiranë. AKP-ja kryen inventarizimin dhe shpërndarjen e tyre në qendrat e vlerësimit.

7. Vlerësimi i testeve të maturantëve/kandidatëve në provimet e Maturës Shtetërore 2012 do të bëhet në qendrat e mëposhtme:

a) Në Tiranë, në godinën e shkollës "Sabaudin Gabrani", qendra nr. 1;

b) Në Tiranë, në godinën e shkollës "Sabaudin Gabrani", qendra nr. 2;

c) Në Elbasan, në godinën e shkollës "Vasil Kamami;

d) Në Shkodër, në godinën e shkollës "Jordan Misja";

e) Në Fier, në godinën e shkollës "Naim Frashëri";

f) Në Korçë, në godinën e shkollës "Sevasti Qiriazi".

8. Vlerësimi i testeve të Maturës Shtetërore 2012, të ndjekë procedurat e përcaktuara në nenin 50 të rregullores së Maturës Shtetërore, 2012.

9. Drejtoritë Arsimore Rajonale Tiranë, Elbasan, Shkodër, Fier dhe Korçë të marrin masa për lirimin e mjediseve për vlerësimin e testeve në godinat e sipërpërmendura dhe për ruajtjen e tyre me shërbim 24 orësh me roje të të policisë së shtetit, gjatë periudhës 2 qershor-12 korrik 2012.

10. Pas çdo provimi të Maturës Shtetërore 2012, në secilën nga 6 qendrat e vlerësimit, të funksionojë në mënyrë permanente një grup i administrimit dhe monitorimit të testeve, me përbërje si më poshtë:

a) një përfaqësues i AKP-së;

b) një përfaqësues i DEPU-së;

c) një përfaqësues i DAR-së përkatëse.

11. Për drejtimin teknik të procesit të vlerësimit, AKP-ja të caktojë në çdo qendër e për secilin provim dy specialistë të cilët do të përzgjidhen e trajnohen prej saj.

12. Transporti i testeve nga Tirana për në secilën nga qendrat e vlerësimit Elbasan, Shkodër, Fier, Korçë dhe anasjelltas, të bëhet me automjete të DAR-së përkatëse, nga grupi i administratorëve të përmendur në pikën 10 të këtij kreu, nën masa të rrepta sigurie.

KREU III
MONITORIMI I PROCESIT TË KORRIGJIMIT TË PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2012

13. Grupi monitorues në Qendrën e Vlerësimit ka detyrat e mëposhtme:

a) Kontrollon nëse është siguruar ruajtja nga policia e objektit ku janë vendosur testet.

b) Përgjigjet për tërheqjen e testeve nga AKP-ja dhe për transportimin e tyre drejt Qendrës së Vlerësimit.

c) Merr në dorëzim testet nëpërmjet një procesverbali që firmoset nga tre përfaqësuesit e grupit monitorues, si edhe nga personi i sektorit të administrimit të testeve në AKP, i cili bën dorëzimin e tyre.

d) Qëndron në mjediset e Qendrës së Vlerësimit gjatë procesit të korrigjimit dhe raporton në institucionet përkatëse.

14. Personat që bëjnë pjesë në grupet e monitorimit të procesit të korrigjimit të provimeve të Maturës Shtetërore 2012 për secilën qendër vlerësimi, caktohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

15. Periudha e monitorimit dhe grafiku i paraqitjes së përfaqësuesve të grupit monitorues në AKP është:

a) Për lëndën "Gjuhë dhe letërsi shqipe" 3-13 qershor 2012;

b) Për lëndën "Matematikë": 17-29 qershor 2012;

c) Për lëndët me zgjedhje: 2-10 korrik 2012.

KREU IV
ORARET E FILLIMIT TË PROVIMEVE

16. Provimet e lirimit 2012 të fillojnë në orën 10:00.

17. Provimet e Maturës Shtetërore 2012, të detyruara dhe me zgjedhje, të fillojnë në orën 10:00.

18. Maturantëve/kandidatëve që janë të paraburgosur, u sigurohen kushtet për zhvillimin normal të provimeve, në mjedise të posaçme nën mbikëqyrjen e përfaqësuesve të policisë, në përputhje me nenin 47, pika 4 të "Rregullores për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2012".

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

19. Punonjësit që angazhohen jashtë kohës normale të punës në procesin e administrimit dhe të vlerësimit të provimeve të Maturës Shtetërore 2012, të paguhen sipas akteve nënligjore në fuqi.

20. Shpenzimet e udhëtimit, hotelit dhe ushqimit të specialistëve të përfshirë në këtë proces mbulohen nga institucionet përkatëse.

21. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Koordinimit Rajonal, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, AKP, IZHA, IKAP, AKAFP, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr. 282, datë 15.6.2012

PËR MBAJTJEN E PROCESVERBALIT TË SEANCËS GJYQËSORE ME MJETE AUDIO

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe paragrafit 7 e 8 të nenit 6, paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, Ministri i Drejtësisë

UDHËZON:
KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky udhëzim përcakton rregullat e detyrueshme mbi:

a) mbajtjen fjalë për fjalë të procesverbaleve të seancave gjyqësore, nëpërmjet regjistrimit audio, përmes mjeteve digjitale, në të gjitha ambientet e gjykatave ku zhvillohen seanca gjyqësore, në përputhje me nenet 77, 118 dhe 172 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenet 115 deri 122 të Kodit të Procedurës Penale dhe me çdo dispozitë tjetër procedurale në fuqi;

b) funksionimin e sistemit të regjistrimit audio; dhe

c) mënyrën e ruajtjes së materialeve të këtyre regjistrimeve audio dhe përgatitjes, kur është e nevojshme, të transkripteve të tyre.

Neni 2
Fusha e veprimit

Mjetet digjitale audio të regjistrimit të seancave gjyqësore përdoren për regjistrimin e seancave gjyqësore të gjykimeve penale, administrative dhe civile, të zhvilluara në ambientet e gjykatave ku zhvillohen seanca gjyqësore, në të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3
Sistemi i regjistrimit audio

1. Sistemi i regjistrimit audio është tërësia e pajisjeve digjitale dhe e proceseve që mundësojnë regjistrimin audio të seancës gjyqësore.

2. Sistemi i regjistrimit audio integrohet në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore (ICMIS).

3. Materiali i regjistrimit audio të seancave gjyqësore, së bashku me procesverbalin e mbajtur nga sekretari gjyqësor, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij udhëzimi, përbëjnë procesverbalin e seancës gjyqësore.

KREU II
REGJISTRIMI AUDIO I SEANCAVE GJYQËSORE DHE PËRGJEGJËSITË PËRKATËSE

Neni 4
Regjistrimi audio i seancës gjyqësore

1. Regjistrimi audio i seancës gjyqësore kryhet nga sekretari gjyqësor, nën udhëzimet dhe mbikëqyrjen e kryetarit të seancës gjyqësore, duke përdorur pajisjet digjitale të posaçme për regjistrimin.

2. Për çdo seancë gjyqësore të regjistruar, sekretari gjyqësor mban procesverbalin e seancës, duke përdorur seksionin e shënimeve në sistemin e regjistrimit audio, në të cilin ai shënon vitin, muajin, datën, vendin ku mbahet seanca, përbërjen e trupit gjykues, emrin e sekretarit gjyqësor, gjeneralitetet e palëve, përfaqësuesve të tyre dhe personave të tjerë të thirrur për të marrë pjesë në seancën gjyqësore, përmbledhjen e deklaratave, kërkesave dhe pretendimeve të palëve, përmbledhjen e vendimeve të ndërmjetme të gjykatës, si dhe të dhëna të tjera të rëndësishme, në përputhje me nenin 118 të Kodit të Procedurës Civile, nenin 345 të Kodit të Procedurës Penale dhe çdo normë tjetër procedurale në fuqi, si dhe orën e fillimit dhe mbarimit të regjistrimit. Këto shënime nënshkruhen nga kryetari i seancës gjyqësore dhe sekretari gjyqësor.

3. Kur regjistrimi i seancës gjyqësore është i pamundur të realizohet, për shkak të defekteve në pajisje, procesverbali i seancës mbahet në një nga mënyrat e tjera të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale ose Kodi i Procedurës Civile apo çdo normë tjetër procedurale në fuqi sipas përcaktimit të kryetarit të seancës gjyqësore. Në këtë rast, në procesverbal shënohet shkaku i mbajtjes së procesverbalit në mënyrën tjetër.

4. Shënimet e printuara të nënshkruara nga sekretari gjyqësor dhe kryetari i seancës gjyqësore, si dhe transkriptet e regjistrimeve (zbardhja), kur ka të tilla, i bashkohen dosjes gjyqësore, si pjesë përbërëse dhe e pandashme e procesverbalit gjyqësor.

Neni 5
Elementet e domosdoshme të regjistrimit

1. Regjistrimi audio fillon dhe mbaron në të njëjtën kohë me seancën gjyqësore. Ai përmban të gjitha komunikimet verbale ndërmjet palëve, të gjitha vendimet verbale dhe urdhrat e gjykatës, si dhe të gjitha kërkesat, deklarimet dhe pretendimet e palëve.

2. Në çdo rast, regjistrimi duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm, siç lexohet nga kryetari i seancës gjyqësore në fillim të seancës:

a) përbërjen e trupit gjykues dhe emrin e sekretarit gjyqësor;

b) gjeneralitetet e palëve, përfaqësuesve të tyre dhe personave që janë thirrur për të marrë pjesë në seancën gjyqësore;

c) kur është rasti, shkaqet e mungesës së palëve, përfaqësuesve të tyre dhe personave që janë thirrur për të marrë pjesë në seancën gjyqësore.

Neni 6
Kryetari i seancës gjyqësore

1. Kryetari i seancës gjyqësore mbikëqyr procesin e regjistrimit të seancave gjyqësore dhe, për këtë qëllim, i jep udhëzime sekretarit gjyqësor, si dhe u jep urdhra palëve, përfaqësuesve të tyre dhe pjesëmarrësve në seancë gjyqësore.

2. Për mbarëvajtjen e procesit të regjistrimit, kryetari i seancës gjyqësore, ndër të tjera:

a) në fillim të seancës gjyqësore, informon të gjithë personat e pranishëm se procedimi po regjistrohet elektronikisht.

b) udhëzon palët që të flasin qartë në mikrofon, të përgjigjen me fjalë dhe të shmangin gjestet ose lëvizjet e kokës, pasi këto gjeste nuk mund të kapen nga regjistrimi;

c) sigurohet që regjistrimi të realizohet në përputhje me rregullat e këtij udhëzimi dhe të përmbajë të dhënat e kërkuara;

ç) vendos për mbajtjen e procesverbalit në mënyra të tjera, në rastet e parashikuara në këtë udhëzim;

d) vendos ta kufizojë aksesin e regjistrimit, në rastet kur gjatë seancës diskutohen çështje delikate që kanë të bëjnë me të miturit, sekrete shtetërore, të dhëna financiare të palëve, çështje të sigurisë së dëshmitarëve ose të të paditurve ose kur një gjë e tillë kërkohet nga palët dhe pranohet nga gjykata me vendim të arsyetuar të saj, në përputhje me parashikimet përkatëse të legjislacionit procedural në fuqi.

Neni 7
Sekretari gjyqësor

1. Sekretari gjyqësor është përgjegjës për:

a) vënien në funksionim të pajisjeve të regjistrimit;

b) regjistrimin e plotë e të saktë të seancave gjyqësore;

c) transkriptimin e tyre, kur kërkohet;

ç) arkivimin e regjistrimeve; dhe

d) lëshimin e kopjeve të vërtetuara të regjistrimit origjinal, në formë të pamodifikueshme, në DVD-të e paraqitura paraprakisht nga palët, si dhe të kopjeve të vërtetuara të shënimeve origjinale, pas pagesës së plotë të tarifës përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

2. Sekretari gjyqësor realizon detyrat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, Kodin e Procedurës Penale, legjislacionin për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, këtë udhëzim dhe udhëzimet e kryetarit të seancës gjyqësore, si dhe duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Për realizimin e detyrave të përcaktuara në këtë udhëzim, si dhe të atyre të ngarkuara nga kryetari i seancës gjyqësore, sekretari gjyqësor kryen, edhe me iniciativën e vet, të gjitha veprimet që garantojnë regjistrimin e plotë dhe të qartë të seancës. Ndër të tjera, sekretari gjyqësor:

a) sigurohet që pajisjet e regjistrimit janë në gjendje pune dhe se materialet e nevojshme janë të gatshme para se të fillojë seanca gjyqësore;

b) mban nën vëzhgim pajisjet e regjistrimit, për t'u siguruar se punojnë saktësisht gjatë gjithë seancës;

c) njofton kryetarin e seancës që pjesëmarrësit në seancë gjyqësore, kur është e nevojshme, duhet të ngrenë zërin apo të flasin më qartë, të flasin në mikrofon, të shqiptojnë saktë emrat apo termat, të mos bëjnë zhurma apo përdorin pajisje që ndërhyjnë në cilësinë e regjistrimit;

ç) njofton kryetarin e seancës gjyqësore për çdo problem me pajisjen e regjistrimit dhe i kërkon kryetarit të seancës që pjesëmarrësit të përsërisin fjalën në seancë apo të urdhërojë kalimin në një mënyrë tjetër të mbajtjes së procesverbalit gjyqësor, kur është e nevojshme;

d) siguron ruajtjen e sigurt të regjistrimit audio në përfundim të seancës gjyqësore, duke mbyllur dosjen (çështjen) në ICMIS, nga ku mund të aksesohet materiali i regjistruar prej përdoruesve të tij përmes fjalëkalimeve përkatëse;

dh) bën transkriptimin e regjistrimeve, kur kërkohet;

e) siguron përfshirjen e materialeve të regjistrimit dhe transkriptimeve në dosjen gjyqësore, kur kërkohet; dhe

ë) lëshon kopje dhe ekstrakte të vërtetuara të regjistrimit audio dhe shënimeve, në kushtet e parashikuara në shkronjën "d" të paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 8
Personeli ndihmës i gjykatës

Personeli ndihmës i gjykatës asiston sekretarin gjyqësor në përmbushjen e detyrave të tij për regjistrimin e seancave gjyqësore.

Neni 9
Teknikët e mjeteve

Në raste të caktuara, në përmbushjen e detyrave të tij për regjistrimin e seancave gjyqësore, sekretari gjyqësor ndihmohet nga persona me njohuri teknike, të cilët nuk janë punonjës të gjykatës, por janë kontaktuar prej saj për këtë qëllim. Në çdo rast, sekretari gjyqësor mbikëqyr procesin e regjistrimit dhe mban përgjegjësi për të.

Neni 10
Kancelari i gjykatës

Kancelari i gjykatës, krahas përgjegjësive të tjera të parashikuara në këtë udhëzim, raporton me shkrim pranë Ministrit të Drejtësisë çdo dy muaj ose në çdo rast, kur i kërkohet, për ecurinë e zbatimit të këtij udhëzimi në gjykatë. Raporti përgatitet, pasi merret edhe mendimi i kryetarit të gjykatës.

KREU III
PROCEDURA E REGJISTRIMIT

Neni 11
Masat përgatitore para seancës gjyqësore

Para fillimit të seancës gjyqësore, sekretari gjyqësor, krahas detyrave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që pajisjet e regjistrimit të funksionojnë si duhet. Ndër të tjera, sekretari gjyqësor:

a) kontrollon që të gjitha pajisjet të jenë lidhur në priza dhe të furnizohen me energji elektrike;

b) kontrollon që të gjitha pajisjet të jenë lidhur me bateritë (UPS) përkatëse dhe që gjeneratori të jetë në gjendje pune dhe i gatshëm për t'u ndezur, nëse ndërpritet energjia elektrike;

c) kontrollon që të gjithë mikrofonat të jenë të lidhur me kanalet përkatëse;

d) ndez të gjitha pajisjet e regjistrimit dhe provon të gjithë mikrofonat, duke bërë regjistrime provë;

e) sigurohet që palët dhe pjesëmarrësit e tjerë janë ulur në vendet përkatëse, për të bërë të mundur regjistrimin audio;

f) sigurohet që ka hapësirë të mjaftueshme në disk për regjistrimin;

g) sigurohet që ka në dispozicion mjetet e nevojshme për mbajtjen e procesverbalit në një mënyrë alternative, kur kjo është e nevojshme.

Neni 12
Problemet me pajisjet

Kur, gjatë seancës gjyqësore, pajisjet e regjistrimit janë ndezur, por shfaqen probleme me funksionimin e tyre/regjistrimin, sekretari lajmëron kryetarin e seancës, i cili urdhëron që të vijohet me një mënyrë tjetër të mbajtjes së procesverbalit gjyqësor.

Neni 13
Problemet në furnizimin me energji elektrike

Në rast të mungesës së papritur të energjisë elektrike, sekretari gjyqësor njofton kryetarin e seancës duke e vënë në dijeni për kohën që ka në dispozicion nga bateria (UPS) dhe/ose gjeneratori, në mënyrë që, kur është nevoja, të merren masat për vijimin me një mënyrë tjetër të mbajtjes së procesverbalit gjyqësor.

Neni 14
Fillimi dhe mbarimi i regjistrimit

1. Regjistrimi i seancës fillon në momentin që trupi gjykues hyn në sallë.

2. Regjistrimi përfundon në momentin që trupi gjykues e deklaron të mbyllur seancën gjyqësore.

Neni 15
Provat audio ose audio dhe video

1. Kur gjatë seancës merren si prova regjistrime audio dhe video, sekretari gjyqësor i kërkon kryetarit të seancës gjyqësore kohë për të rregulluar mikrofonat në mënyrë që të regjistrohet materiali/prova që do të dëgjohet dhe shihet.

2. Pas përfundimit të marrjes së provës sipas paragrafit 1 të këtij neni, sekretari kërkon përsëri kohë për të kthyer pajisjet në gjendjen e mëparshme.

Neni 16
Videokonferencat

Kur gjykata lejon marrjen e një dëshmie me anë të videokonferencës, regjistrimi i dëshmisë bëhet nga vetë pajisja e videokonferencës. Kur kjo nuk është e mundur, sekretari gjyqësor merr masa që njëri nga mikrofonat e pajisjes së regjistrimit audio të regjistrojë pjesën zanore të videokonferencës.

Neni 17
Përfundimi i regjistrimit

Pas përfundimit të seancës gjyqësore sekretari gjyqësor mbyll dosjen me materialin e regjistruar, bën një kopje rezervë të këtij materiali, mbyll dosjen në ICMIS, si dhe fik pajisjet dhe bateritë.

Neni 18
Ruajtja e regjistrimit origjinal

1. Regjistrimi i plotë origjinal ruhet në serverin e gjykatës, deri në përfundim të gjykimit.
2. Kur vendimi për një çështje gjyqësore merr formë të prerë, regjistrimet për çështjen përkatëse arkivohen në serverin qendror të Ministrisë së Drejtësisë.
3. Regjistrimi shkatërrohet në momentin kur shkatërrohet edhe dosja e çështjes, sipas legjislacionit në fuqi.

KREU IV
SIGURIMI I KOPJEVE TË REGJISTRIMIT ORIGJINAL PËR PALËT DHE PUBLIKUN

Neni 19
Pajisja e palëve me kopjen e regjistrimit

1. Palët, kur dëshirojnë të kenë një kopje të certifikuar të origjinalit të regjistrimit, paraqesin kërkesë në përfundim të seancës gjyqësore ose më pas në sekretarinë gjyqësore.
2. Sekretari gjyqësor u jep palëve kopje të certifikuara të origjinalit të regjistrimit në DVD, në formë të pamodifikueshme (read only), si dhe kopje të certifikuara të shënimeve origjinale, sipas disponimit të kryetarit të seancës, pas pagesës së plotë nga palët të tarifës së vendosur, sipas legjislacionit në fuqi.
3. DVD-të e papërdorura duhet të sigurohen nga vetë palët.
4. Kopjet e origjinaleve të përmendura më sipër u jepen palëve brenda 24 orëve pas përfundimit të gjykimit dhe 48 orëve nga pagesa e tarifës së vendosur, kur çështja është ende në gjykim.
5. Në rast refuzimi të kërkesës së palëve për pajisjen e tyre me kopje të certifikuara të origjinalit të regjistrimit, kryetari i seancës arsyeton vendimin e tij dhe ky arsyetim i bëhet i ditur palës kërkuese.
6. Çdo informacion shtesë i kërkuar nga palët shqyrtohet sipas legjislacionit në fuqi që rregullon marrëdhëniet e gjykatës me publikun.

Neni 20
Pajisja e publikut me kopjen e regjistrimit

Për kërkesat për pajisje me kopje të certifikuar të origjinalit të regjistrimit të paraqitura nga publiku ose media, zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 19 të këtij udhëzimi, për aq kohë sa ato nuk bien ndesh me parashikimet e bëra në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 21
Ankesat

Ankesat e palëve ose të publikut për shkelje të afateve ose për mosdhënie të informacionit të kërkuar sipas neneve 19 dhe 20 të këtij udhëzimi, paraqiten pranë Kancelarit të Gjykatës, i cili përgjigjet me shkrim brenda 48 orëve nga momenti i paraqitjes së ankesës.

KREU V
TRANSKRIPTET E REGJISTRIMEVE

Neni 22
Përgatitja e transkriptit

1. Transkripti i regjistrimit përgatitet nga sekretari gjyqësor ose teknikët audio të kontraktuar nga gjykata dhe që janë nën mbikëqyrjen e sekretarit gjyqësor, në rastet kur:

a) kërkohet nga anëtarët e trupit gjykues;

b) kërkohet nga palët në gjykim ose persona të tjerë të interesuar, me kusht që ata ta argumentojnë me shkrim këtë kërkesë dhe në rast se kjo kërkesë miratohet nga kryetari i seancës gjyqësore, si dhe pasi të paguhen tarifat e vendosura për këtë qëllim.

2. Transkriptimi i regjistrimit mund të bëhet për të gjitha seancat e një çështjeje, për seanca të veçanta ose për pjesë të shkëputura prej tyre, sipas kërkesës së personit që kërkon transkriptimin.

3. Transkriptimi mund të kërkohet edhe para se gjykata të ketë dhënë vendimin për çështjen.

4. Transkriptimi mund të bëhet edhe nga vetë palët për përdorim personal.

Neni 23
Përmbajtja e transkriptit

1. Transkripti përmban gjithçka që gjykata dhe pjesëmarrësit në seancën gjyqësore kanë thënë gjatë saj. Sekretari gjyqësor i kushton kujdes të veçantë identifikimit në transkript të çdo folësi.

2. Nëse transkripti përmban disa seanca gjyqësore, këto duhet të renditen në mënyrë kronologjike.

3. Transkripti shoqërohet me një indeks, i cili tregon seancat gjyqësore për të cilat është bërë regjistrimi.

4. Transkripti nënshkruhet nga sekretari gjyqësor.

5. Nëse seanca gjyqësore është zhvilluar me përkthyes, transkripti nënshkruhet edhe nga përkthyesi, për të vërtetuar saktësinë e përkthimit.

Neni 24
Kontrolli dhe korigjimi i transkriptit zyrtar

1. Kur palët në një gjykim kanë dyshime apo kundërshtime në lidhje me saktësinë e transkriptit, ato paraqesin një kërkesë me shkrim në sekretarinë gjyqësore, në të cilën evidentojnë në mënyrë specifike orën dhe datën e atyre pjesëve të regjistrimit që vihen në diskutim.

2. Me marrjen e kërkesës me shkrim për korrigjim, sekretari gjyqësor kontrollon regjistrimin dhe bën korrigjimet në transkript, kur është rasti. Kur pjesët e diskutuara të transkriptit kanë të bëjnë me përkthimin, sekretari kërkon kontrollin nga përkthyesi para bërjes së korrigjimeve. Kur sekretari konstaton se nuk ka vend për korrigjim, ai njofton me shkrim për këtë fakt personin që kërkoi korrigjimin.

3. Transkripti i korrigjuar mban shënimin përkatës për datën e korrigjimit dhe konsiderohet versioni përfundimtar i transkriptit. Palët dhe personat e tjerë të interesuar marrin kopje të versionit të korrigjuar, sipas kërkesës së tyre dhe përkundrejt pagesës përkatëse. Kur kopje të transkriptit janë dorëzuar në gjykata të shkallëve të tjera, këto kopje zëvendësohen me kopjen e korrigjuar.

Neni 25
Pjesët e pakuptueshme të transkriptimit

Kur sekretari gjyqësor e ka të pamundur të dëgjojë a kuptojë ndonjë pjesë të regjistrimit, ai bën shënimin përkatës me fjalën “e pakuptueshme” në tekstin e transkriptit.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 26
Dispozitë kalimtare

1. Zbatimi i këtij udhëzimi nga secila gjykatë, fillon në momentin e përfundimit të instalimit të pajisjeve digjitale të regjistrimit audio në gjykatën përkatëse.

2. Ngarkohet kancelari i çdo gjykate të njoftojë me shkrim Ministrinë e Drejtësisë fillimin e zbatimit të këtij udhëzimi.

Neni 27
Ndjekja e zbatimit dhe njoftimi i udhëzimit

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë për njoftimin e këtij udhëzimi dhe ndjekjen e zbatimit të tij.

Neni 28
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

URDHËR
Nr. 90, datë 30.5.2012

PËR DOKUMENTET QË DUHET TË PARAQESIN SHTETASIT SHQIPTARË PËR NDRYSHIMIN E EMRIT/MBIEMRIT NË ZYRAT E GJENDJES CIVILE DHE PROCEDURËN QË DUHET TË NDJEKË NËPUNËSI I GJENDJES CIVILE

Në vijim të konsolidimit të praktikës së ndryshimit të emrit/mbiemrit nga ana e shtetasve shqiptarë dhe në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të pikës 1, 2 dhe 6 të nenit 57 të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit,

URDHËROJ:

1. Shtetasit shqiptarë që do të ndryshojnë emrin/mbiemrin, do të paraqesin para nëpunësit të shërbimit të gjendjes civile, së bashku me kërkesën, dhe:

a) vërtetim sipas modelit nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri, nga drejtoria rajonale përkatëse për kufirin dhe migracionin, sipas ndarjes nr. 2, bashkëlidhur këtij urdhri;

b) fotokopje të letërnjoftimit elektronik individual që ka në përdorim.

2. Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile për të gjithë shtetasit që nuk kanë dokumentet sipas pikës 1 të këtij urdhri, ose që e kanë vërtetimin me shënimin DEPORTIV/INAD, nuk do të kryejë veprime për ndryshimin e emrit/mbiemrit, deri në pajisjen nga ana e tyre me këtë vërtetim pa shënimin DEPORTIV/INAD.

3. Këto dokumente nëpunësi i zyrës së gjendjes civile do t'i ruajë deri në kohën e përfundimit të afatit të kufizimit të ndryshimit të emrit/mbiemrit.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
100 Vjet Pavarësi
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Shtetit
Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin

Nr. _____Prot. **_____ më __.__.2012.**

VËRTETIM

Vërtetojmë se shtetasi/ja_____, me numër personal_____
(Emri, mbiemri)
datëlindje ____ . _____ . _____, vendlindje _____ dhe banues/e në
_____, me shtetësi _____ rezulton ☐ nuk rezulton ☐ i/e
(Bashkia/Komuna)
kthyer si person i kategorisë DEPORTIV ☐, INAD ☐, në Pikën e Kalimit Kufitar
_____, më datë ___ . ___ ._____, nga autoritetet policore të vendeve të
Bashkimit Evropian.

E lëshojmë këtë vërtetim për efekt dokumenti.

DREJTORI

_____
Nënshkrimi (Vula)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Shtetit
Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin

100 Vjet Pavarësi

Lista e drejtorive rajonale për kufirin dhe emigracionin në territorin e Republikës së Shqipërisë edhe emrat e rretheve që mbulon secila prej tyre sipas juridiksionit territorial:

1. Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Tiranë mbulon rrethet: Tiranë, Elbasan, Gramsh, Peqin dhe Librazhd;

2. Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Durrës mbulon rrethet: Durrës, Kavajë, Lushnjë, Krujë, Lezhë, Laç dhe Mirditë;

3. Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Shkodër mbulon rrethet: Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë;

4. Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Kukës mbulon rrethet: Kukës, Has dhe Tropojë;

5. Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Dibër mbulon rrethet: Dibër, Bulqizë dhe Burrel;

6. Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Korçë mbulon rrethet: Korçë, Pogradec, Devoll dhe Ersekë;

7. Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Gjirokastër mbulon rrethet: Gjirokastër, Përmet dhe Tepelenë;

8. Drejtoria Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Vlorë mbulon rrethet: Vlorë, Fier, Mallakastër, Berat, Kuçovë, Skrapar, Sarandë dhe Delvinë.

VENDIM
Nr. 69, datë 24.5.2012

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR "TV KABLLOR DELVINA"

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr. 01, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat kabllor "TV Kabllor Delvina", në fushën e transmetimeve televizive kabllore private.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet nga data 5.9.2011 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr. 70, datë 24.5.2012

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR "TV SUPER SONIC"

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr. 01, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat vendor "TV Super Sonic", në fushën e transmetimeve televizive vendore private.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet nga data 15.5.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr. 71, datë 24.5.2012

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR "TV MARGIT"

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr. 01, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat vendor "TV Margit", në fushën e transmetimeve televizive vendore private.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet nga data 15.5.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr. 72, datë 24.5.2012

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR "TV SARANDA"

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr. 01, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat vendor "TV Saranda", në fushën e transmetimeve televizive vendore private.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet nga data 28.1.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr. 83, datë 24.5.2012

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR "TV ROZAFA MOTIV"

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr. 01, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat vendor "TV Rozafa Motiv", në fushën e transmetimeve televizive vendore private.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet nga data 3.1.2011 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

KËRKESË
Nr. 906/3, datë 21.5.2012

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Vora By Pass" Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë më dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja" do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë të rifreskuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e shpronësimit për objektet është 13 314 866 (trembëdhjetë milionë e treqind e katërmbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I MBIKALIMIT TË VORËS, OBJEKTET

Nr.	Pronari		Zona	Lloji i pasurisë	Vlera	Shënime
	Emri	Mbiemri				
1	Ramazan	Bera	Marqinet (Vorë)	Shtëpi banimi	4099844	Në proces legalizimi
2	Liman	Koboçi	Marqinet (Vorë)	Shtëpi banimi	5685451	Në proces legalizimi
3	Mynevere	Spaho	Marikaj (Vorë)	Punishte	1740623	Konfirmuar nga ZRPP-ja
4	Xhavit	Picari	Marikaj (Vorë)	Magazinë	801382	Konfirmuar nga ZRPP-ja
5	Zenel	Hoxha	Mucaj (Vorë)	Ndërtesë	570336	Proces rivlerësimi
6	Hamza	Subashi	Mucaj (Vorë)	Ndërtesë	417230	Proces rivlerësimi
7	**Shuma**				**13314866**	

KËRKESË
Nr. 2437, datë 23.5.2012

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Qafë -Thanë-Lin-Pogradec" Loti I (shtesat)

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar.

Pronari që ka emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pronari, për të cilin në kolonën shënime në tabelën e publikuar është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja", do të kompensohet për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të ketë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë të rifreskuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e shpronësimit për tokën arë është 218 311.8 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e njëmbëdhjetë pikë tetë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "QAFË-THANË-LIN-POGRADEC" LOTI I

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pasurisë	Sip totale	Lloji i pasurisë			Vlera totale (lekë)	Shënime
							Arë				
							Sip.	Çmimi	Vlera		
1	Resul	Dalip	Avdillari	2457	113/1	2400	826	264.3	218311.8	218311.8	Konfirmim, ZVRPP
Shuma									**218311.8**		

KËRKESË
Nr. 4753/3, datë 31.5.2012

PËR SHPRONËSIM ME INTERES PUBLIK

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit tokë bujqësore, tokë truall, ndërtim, shtëpi banimi dhe "kulturave bujqësore" që preken nga "Ndërtimi i linjës 110 kV Tirana 2-Nënstacioni 110 kV Kashar-Selitë".

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është "Operatori i Sistemit të Transmetimit" sh.a. Tiranë.

Me anën e këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15 ditëve pas publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit.

MINISTRI I EKONOMISË,TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço

LISTA E PRONARËVE QË ZHDËMTOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS ELEKTRIKE 110 KV "TIRANA 2-KASHAR 2"

Komuna Kashar

LISTA E PRONARËVE									
Nr. i shtyllës	**Emri, mbiemri**	**Zona kadastrale**	**Nr. i pasurisë**	**Lloji i pasurisë**	**Sipërfaqe shtylle**	**Çmimi lekë/m²**	**Vlera në lekë**	**Fshati**	**Shënime për pronësinë**
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	Reshat Sorra Ramiz Sorra	2105	119/2 119/3	Arë	44	415	18,077	Kashar	Pronësi me certifikatë
2	Agim Dema	2105	33/6	Arë	50	415	20,756	Kashar	Pronësi me certifikatë
3	Pretendim pronësie	2105	79/1	Kullotë	55	180	9,846	Kashar	S'ka informacion
4	Pretendim pronësie	2105	81/12, 81/14	Arë	58	415	23,970	Kashar	S'ka informacion
5	Pretendim pronësie	2105	105	Pyll	59	52	3,082	Kashar	S'ka informacion
6	Besim Dervishi Pretendim prone	2105	93/10 260/1	Arë	42	415	17,388	Kashar	Certifikatë S'ka informacion
7	Pretendim pronësie	2105	271/1	Pyll	44	52	2,265	Kashar	S'ka informacion
8	Pretendim pronësie	2105	330/31	Arë	58	415	23,970	Kashar	S'ka informacion
9	Shtet	2105	344/1, 344/3, 344/4	Varrezë	42	-		Kashar	S'ka informacion
10	Pretendim pronësie	2105	568/1	Arë	44	415	18,077	Kashar	S'ka informacion
11	Pretendim pronësie	3865	568/17, 568/18	Arë	58	483	27,898	Yrshek	S'ka informacion
12	Pretendim pronësie	3865	552	Arë	59	483	28,630	Yrshek	S'ka informacion
13	Pretendim pronësie	3865	327	Arë	50	483	24,157	Yrshek	S'ka informacion
14	Pretendim pronësie	3865	327	Arë	58	483	27,898	Yrshek	S'ka informacion
15	Pretendim pronësie	3865	327	Arë	44	483	21,039	Yrshek	S'ka informacion
16	Sadik Berziu	2679	288	Pemëtore Arë	68	365	24,884	Mëzez	Certifikatë
17	Pretendim pronësie	2679	287	Arë	39	365	14,056	Mëzez	S'ka informacion
18	Pretendim pronësie	2679	1/24	Arë	58	365	21,082	Mëzez	S'ka informacion
19	Shtet	2679	2/12	Arë	39	365	14,056	Mëzez	S'ka informacion

Shuma 965 Shuma 341,134

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 19.6.2012
Doli nga shtypi më 20.6.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 40 lekë